

# **PROGRAMI I TRANSPARENCËS**

## **PËR DEPARTAMENTIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE**

### **I. HYRJE**

Në zbatim të neneve 2, pika 5 dhe 4-7, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është përgatitur programi i transparencës për Departamentin e Administratës Publike, i cili është një institucion i administratës shtetërore. Ky program përcakton tërësinë e informacionit dhe mënyrat e bërjes publike të tij dhe është hartuar duke iu referuar modeleve të miratuara nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ai mbështetet në kornizën ligjore të veprimtarisë së institucionit si organ publik dhe dispozitat e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të cilit shkurtimisht në vijim do t’i referohemi LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë përmes së cilës Departamenti i Administratës Publike (në vijim DAP) rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. DAP do të përditësojë herë pas here programin e transparencës, në përputhje me nenin 5 të LDI-së. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të evidentojë transparencën e veprimtarisë së punës së DAP-it, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të saj në faqen zyrtare [www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al), si dhe në mjediset e pritjes së publikut.

Programi i transparencës përfshin, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme prej publikut, disa kategori informacioni si, bazën juridike, rubrika, tekste, afate, strukturën dhe organikën e institucionit, mauale, procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, vendodhjen e zyrave, të dhëna mbi funksionarët të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve, të dhëna mbi procedurat e prokurimit, regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, informacione dhe dokumente që kërkohen më shpesh, etj.

Në përmbajtje të programit të transparencës konstatohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare të internetit. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe nëpërmjet skemës. Dokumentacioni i bërë publik do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

### **II. PARIME TË PËRGJITHSHME**

Parimet kryesore në të cilat mbështetet programi i transparencës së DAP-it janë:

1. E drejta për informim është një e drejtë kushtetuese, e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: DAP ushtron funksione publike, e për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e DAP-it dhe përkatësisht: Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.
4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP).
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas të njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
  - i plotë;
  - i saktë;
  - i përditësuar;
  - i thjeshtë në konsultim;
  - i kuptueshëm;
  - lehtësisht i aksesueshëm;
  - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

### **III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË**

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, DAP vendos në dispozicion të publikut nëpërmjet faqes së tij të internetit [www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al), si dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën dhe organikën e DAP-it;

- Tekstet e plota, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit, ose të ndonjë dokumenti tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të institucioneve dhe që prek publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të DAP-it, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit;
- Strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar;
- Informacion për procedurat e prokurimit, apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik-privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, që kryhen për llogari të autoritetit publik;
- Informacion për shërbimet që DAP i jep publikut, duke përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;
- Informacione dhe dokumente që kërkohen më shpesh, si dhe çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre, apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike, apo ushtrimin e funksioneve të DAP-it;
- Një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

DAP, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;

Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga DAP.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

#### **IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE**

<b>Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë</b>	<b>Baza ligjore</b>	<b>Dokumenti/Përmbajtja</b>	<b>Afati kohor për publikim</b>	<b>Mënyra e publikimit</b>	<b>Struktura përgjegjëse</b>
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik. Të dhënat për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë.	Neni 7, pika 1, gërmat a dhe d.	<a href="http://dap.gov.al/images/2019-08-20_DAP_Struktura.pdf">http://dap.gov.al/images/2019-08-20_DAP_Struktura.pdf</a>  <a href="http://dap.gov.al/images/Drejtor%C3%ABt_DAP.pdf">http://dap.gov.al/images/Drejtor%C3%ABt_DAP.pdf</a>  <a href="http://dap.gov.al/images/2019-08-20_DAP_Organika.pdf">http://dap.gov.al/images/2019-08-20_DAP_Organika.pdf</a>	Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari i institucionit.	Menuja “DAP” rubrika “Struktura” në faqen zyrtare të DAP-it.	Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Administratës Publike dhe Sektori Ekonomik dhe Shërbimeve Mbështetëse.
Akte ndërkombëtare, ligje, akte nënligjore, dokumente politikash dhe dokumente të tjera.	Neni 7, pika 1, gërma b.	<a href="http://dap.gov.al/legjislacioni/per-sherbimin-civil">http://dap.gov.al/legjislacioni/per-sherbimin-civil</a>  <a href="http://dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike">http://dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike</a>  <a href="http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale">http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale</a>  <a href="http://dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik">http://dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik</a>	Menjëherë pas botimit në Fletore Zyrtare.	Menuja “Legjislacioni” dhe “Dokumenta” në faqen zyrtare të DAP-it.	Drejtoria e Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore.
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim,	Neni 7, pika 1, gërmat c dhe g.	Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”	Pas miratimit të programit të transparencë	Menuja “Legjislacioni”, rubrika “Për	Koordinatori për të drejtën e informimit.

<p>adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.</p>		<p><a href="http://dap.gov.al/dap/programi-i-transparences/formate">http://dap.gov.al/dap/programi-i-transparences/formate</a></p>	<p>s. Menjëherë në rast ndryshimesh .</p>	<p>administratën publike” në faqen zyrtare të DAP-it. Menuja “DAP”, rubrika “Programi i Transparencës”, ndarja “Formate”, në faqen zyrtare të DAP-it.</p>	
<p>Të dhëna për vendodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.</p>	<p>Neni 7, pika 1, gërma ç dhe 10.</p>	<p>Adresë postare: Këshilli i Ministrave, Bulevardi Dëshmorët e Kombit, nr. 1, Tiranë.</p> <p>Adresë email: <a href="mailto:info@dap.gov.al">info@dap.gov.al</a></p> <p>Orari zyrtar 08:00-16:30, nga e hëna në të enjte dhe 08:00-14:00 ditën e premte.</p> <p>Z. Oltion Musaj - Koordinator për të drejtën e informimit.</p>	<p>Pas caktimit të Koordinatorit për të drejtën e informimit.</p>	<p>Menuja “Home”, rubrika “Kontakt” në faqen zyrtare të DAP-it.</p>	<p>Sektori Ekonomik dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinator për të Drejtën e Informimit.</p>
<p>Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.</p>	<p>Neni 7, pika 1, gërma d.</p>	<p>Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 44/2015, VKM-ja nr. 142, datë 12.03.2014 “Për</p>	<p>Me hyrjen në fuqi të akteve ligjore dhe nënligjore.</p>	<p>Menuja “Legjislacioni”, rubrika “Për shërbimin civil” në faqen zyrtare të DAP-it. Menuja “Legjislacioni”, rubrika</p>	<p>Sektori Ekonomik dhe Shërbimeve Mbështetëse.</p>

		<p>përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, e ndryshuar, VKM-ja nr. 118, datë 05.03.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TNDsë”, e ndryshuar dhe Udhëzimi i DAP-it nr. 6, datë 19.09.2014 “Për procesin e rekrutimit dhe emërimit të nëpunësve të nivelit të lartë drejtues, anëtarë në TND”, i ndryshuar.</p>		<p>“Udhëzime/ manuale” në faqen zyrtare të DAP-it.</p>	
<p>Mekanizmat monitorues, raporte audit, dokumentet me tregues performance.</p>	<p>Neni 7, pika 1, gërma dh.</p>	<p><a href="http://dap.gov.al/publikime/raporte-vjetore">http://dap.gov.al/publikime/raporte-vjetore</a></p>	<p>Menjëherë pas miratimit ose marrjes dijeni nga DAP, ose publikimit në faqen zyrtare të monitoruesve.</p>	<p>Menuja “Dokumente”, rubrika “Raporte vjetore” në faqen zyrtare të DAP-it.</p>	<p>Spektori Ekonomik dhe Shërbimeve Mbështetëse</p>

Informacion mbi buxhetin.	Neni 1, pika 1, gërma e.	Ligji nr. 88/2019 Për buxhetin e vitit 2020, Akti normativ nr. 6, datë 21.03.2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 88/2019 Për buxhetin e vitit 2020 dhe Akti normativ nr. 15, datë 15.04.2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 88/2019 Për buxhetin e vitit 2020.  <a href="http://dap.gov.al/publikime/buxheti">http://dap.gov.al/publikime/buxheti</a>	Pas miratimit të ligjit të buxhetit.	Menuja “Dokumente”, rubrika “Buxheti”, nëndarja “Buxheti 2020” në faqen zyrtare të DAP-it.	Sektori Ekonomik dhe Shërbimeve Mbështetëse.
Informacion për procedurat e prokurimit.	Neni 7, pika 1, gërma e.	<a href="http://dap.gov.al/publikime/buxheti/324-buxheti-2020">http://dap.gov.al/publikime/buxheti/324-buxheti-2020</a>	Menjëherë pas dërgimit në Agjencinë e Prokurimit Publik.	Menuja “Dokumente”, rubrika “Buxheti”, nëndarja “Buxheti 2020” në faqen zyrtare të DAP-it.	Sektori Ekonomik dhe Shërbimeve Mbështetëse
Paraqitja e mendimeve në hartimin e p/akteve, etj.	Neni 7, pika 1, gërma gj.	Projekt-akte ligjore dhe nënligjore. Projekt-Strategji.	Pas nënshkrimit të relacionit shoqërues.	Nëpërmjet adresës zyrtare të institucionit:  <a href="mailto:info@dap.gov.al">info@dap.gov.al</a>	Drejtoria e Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore dhe Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Administratës Publike.
Mbajtja e dokumentacionit nga DAP.	Neni 7, pika 1, gërma h.	Ligj nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.	Pas nënshkrimit, marrjes së numrit të protokollit	Menuja “Legjislacioni”, rubrika “Për administratën	Sektori Ekonomik dhe Shërbimeve Mbështetëse

			dhe vulosjes së tyre, publikimit, apo përditësimit në sistem.	publike” në faqen zyrtare të DAP-it.	
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.	Neni 7, pika 1, gërma i dhe 8.	<a href="http://dap.gov.al/dap/programi-i-transparences/regjistri-i-kërkesave-dhe-pergji-gjeve">http://dap.gov.al/dap/programi-i-transparences/regjistri-i-kërkesave-dhe-pergji-gjeve</a>	Pas miratimit të programit të transparencës.	Menuja “Programi i Transparencës”, Rubrika “Regjistri i kërkesave për informim” në faqen zyrtare të DAP-it, duke ruajtur identitetin e ankuesit.	Koordinatori për të drejtën e informimit.
Informacione dhe dokumente që kërkohen më shpesh.	Neni 7, pika 1, gërma k.	<a href="http://dap.gov.al/ve-nde-vakante/si-te-aplikoni">http://dap.gov.al/ve-nde-vakante/si-te-aplikoni</a>  <a href="http://dap.gov.al/ve-nde-vakante/shpallje">http://dap.gov.al/ve-nde-vakante/shpallje</a>	Pas miratimit nga titullari.  Pas krijimit të çdo vendi vakant.	Menuja “Vende vakante”, rubrika “Si të aplikoni” dhe “Shpallje” në faqen zyrtare të DAP-it.	Drejtoria e Programeve të Reformës në Administratën Publike dhe Drejtoria e Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil
Informacione të tjera të dobishme.	Neni 7, pika 1, gërma l.	<a href="http://dap.gov.al/dap/evente">http://dap.gov.al/dap/evente</a>  <a href="http://dap.gov.al/projekte">http://dap.gov.al/projekte</a>	Pas miratimit nga titullari.	Menuja “DAP”, rubrika “Evente” në faqen zyrtare të DAP-it. Menuja “Trajnime” dhe “Projekte” në faqen zyrtare të DAP-it.	Spektori Ekonomik dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Programeve të Reformës në Administratën Publike.



## **V. PUBLIKIMI**

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, DAP-i vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit [[www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)] dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

## **VI. MONITORIMI**

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit. Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.

Ju falënderojmë për vëmendjen !